

**VENDIM**  
**Nr. 663, datë 2.9.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 181, DATË 30.3.2022, TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË  
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE  
TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) NË  
BASHKITË TIRANË, DURRËS, SHIJAK, LEZHË DHE KRUJË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 181, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pjesën hyrëse, vlera “... 4 254 481 452 (katër miliardë e dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy) lekë ...” zëvendësohet me vlerën “... 3 834 599 901 (tre miliardë e tetëqind e tridhjetë e katër milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e një) lekë ...”;

b) Në shkronjën “a”, vlera “... 1 166 365 230 (një miliard e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë) lekë ...” zëvendësohet me vlerën “... 746 483 679 (shtatëqind e dyzet e gjashtë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë ...”.

2. Në pikën 2/3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pjesën hyrëse, vlera “... 1 079 695 259 (një miliard e shtatëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë ...” zëvendësohet me vlerën “... 880 926 422 (tetëqind e tetëdhjetë milionë e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e njëzet e dy) lekë ...”;

b) Në shkronjën “a”, vlera “... 711 979 470 (shtatëqind e njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë ...” zëvendësohet me vlerën “... 513 210 633 (pesëqind e trembëdhjetë milionë e dyqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre) lekë ...”.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**